



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **100**

Prishtinë, më 30.1.2013, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Daut Haradinaj, Boban Todorović dhe Nijazi Idrizi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 22.1.2013,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndërtesat në bashkëpronësi,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.1.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22.1.2013.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndërtesat në bashkëpronësi

Kryetari në fillim konstatoi se të ftuarit për këtë pikë të rendit të ditës mungojnë për shkak të zgjatjes së mbledhjes plenare, ndërkaq stafi shpërndau letrën e shkruar nga z. Bill Donovan për të cilën **Liburn Aliu** konstatoi se është mjaft e paqartë ngase nuk shihet qartë çka sugjeron z. Bill, ai kërkoi edhe ca sqarime rreth hapësirave publike nëpër ndërtesa dhe mori disa shembuj rreth bashkëpronësisë të cilat doemos duhet të definohen në ligj (p.sh. një tarracë në të cilën ka qasje vetëm një banesë, ndërkaq në fakt është bashkëpronësi, parkingjet, lojnat për fëmijë etj). Pasi që **Afërdita Berisha** kishte disa paqartësi për shkak se koncepti i z. Donovan nuk përshtatet me realitetin tonë, **Kryetari i Komisionit** sugjeroi që ky projekt të rishikohet me amendamente të propozuara nga MMPH në mbledhjen e radhës.

3. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit në këtë pikë vazhdoi me shqyrtimin e **planit të punës së komisionit** për vitin 2013, ashtu si është kërkuar nga komisioni për plotësime eventuale. Pasi që u shqyrtuan në detale çështjet e parapara me plan, ai konstatoi se komisioni do të angazhohet maksimalisht në zbatimin e këtij plani duke pasur mundësi komisioni që të kërkojë tre vizita jashtë, nga mbështetësit përkatës, në bazë të agjendës legjislative.

Meqenëse plani është miratuar në mbledhjen e kaluar, pas miratimit të sotëm me disa plotësime teknike, plani do të dërgohet e nënshkruar në Departamentin Ligjor të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 13,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani